

## MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

*Ndërmjet:*

**Universitetit “Barleti” (UniBa)** Institucion i Arsimit të Lartë, me adresë në rr. Frang Bardhi, Nr. 118, Tiranë, përfaqësuar nga Rektori Prof. Dr. Suzana Guxholli.

*dhe*

**Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë, Tiranë,** përfaqësuar nga Kryetari z. Nikolin Jaka .

Duke u mbështetur në kuadrin ligjor që rregullon veprimtarinë institucionale: në ligjin Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë, ligjin nr. Nr.9640, datë 09.11.2006 “ Për Dhomat e Tregtisë dhe Industrisë në Republikën e Shqipërisë” Ndryshuar me Ligjin Nr. 9897 datë 10.04.2008, palët kanë rënë dakord të lidhin këtë Marrëveshje Bashkëpunimi, në Vijim Marrëveshje.

### Neni 1

#### Qëllimi dhe Objekti

Objekti i kësaj marrëveshje është bashkëpunimi dhe mbështetja reciproke në aplikimin e zbatimin e projekteve dhe nismave në sektorët e mëposhtëm:

1. Pjesëmarrje në leksione të stafit drejtues të Bankës UBA;
2. Organizimi dhe mediatizimi i aktiviteteve të përbashkëta;
3. Pjesëmarrja në praktikat mësimore të studentëve të Universitetit “Barleti” në Bankën UBA;
4. Platforma dhe forume mbi tema specifike të sektorit;
5. Hartimi, përhapja dhe mbështetja e projektligjeve të fushave respektive;
6. Shkëmbimi i praktikave të mira në aspektin manaxherial dhe qeverisës;
7. Trajnime dhe kualifikim të stafeve respektive;
8. Organizimi i Konferencave, Forumeve, Workshopeve dhe Seminareve;
9. Bashkëpunimi me programe, projekte dhe nisma me fonde dhe donacione Kombëtare dhe Ndërkombëtare të fushave respektive.

### Neni 2

#### Informacion mbi palët

1. *Universiteti “BARLETI”* është një universitet privat, i cili ndër vite ka promovuar një nivel të lartë edukimi, duke synuar të zhvillojë prirjet e çdo studenti, me objektivin e krijimit të ekspertëve më të mirë, të aftë për të konkuruar në tregun ndërkombëtar. Misioni i Universitetit është krijimi



i një institucioni akademik elitar, bazuar në praktikat e vlerat më të mira ndërkombëtare, me programe shumëdisiplinore të vënë në jetë nga akademikët më të mirë shqiptarë.

2. *Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë, Tiranë* themeluar më 1926, ushtron aktivitetin e saj në Qarkun Tiranë, dhe kompetencat e saj shtrihen brenda territorit të këtij qarku sipas përcaktimit të ligjit nr.8653 “Për ndarjen administrativo-territoriale” me ndryshimet përkatëse. Dhoma ndërmerret çdo veprimtari, që i shërben nxitjes dhe mbrojtjes së tregtisë e industrisë, në përputhje me objektin e veprimtarisë së saj dhe legjislacionin në fuqi.

### Neni 3

#### Të drejtat dhe detyrimet e palëve

*Universiteti “BARLETI”* (në vijim UniBa):

- a. *UniBa* angazhohet në bashkëpunim me partnerët, për të ndërmarrë të gjitha nismat dhe hapat e nevojshëm organizativë për programimin e çdo aktiviteti e nisme të rënë dakord midis palëve në zbatim të objektit të kësaj marrëveshje.
- b. *UniBa* angazhohet në bashkëpunimin dhe pjesëmarrjen në projekte, trajnime, workshope, forume, konferenca, konsultime, fushata informimi, promovimi e ndërgjegjësimi etj;
- c. *UniBa* angazhohet të mbështesë dhe t’i ofrojë kontribut palëve në marrëveshje, duke vënë në dispozicion stafin e saj akademik në përputhje me ekspertizën e kërkuar nga projekti/ iniciativa;
- d. Personi i kontaktit do të jetë: z. Edvin Stefani. me adresë e-mail: [e.stefani@umb.edu.al](mailto:e.stefani@umb.edu.al).

*Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë, Tiranë* angazhohet:

- a. të jetë partner i qëndrueshëm i palëve në marrëveshje në aplikimet e ndryshme në kuadër të programeve kombëtarë apo ndërkombëtarë me përfitim të përbashkët;
- b. të kërkojë ekspertizë në fushën që institucioni partner mbulon, në përputhje me kërkesat dhe kriteret për një ekspertizë të caktuar;
- c. të punojë së bashku me partnerët përmes nismave të përbashkëta, duke ngritur grupe pune;
- d. Personi i kontaktit do të jetë: z. Nikolin Jaka me adresë e-mail: [cci.tirana@cci.al](mailto:cci.tirana@cci.al).

### Neni 4

#### Kushtet shtesë

Kur është e nevojshme, terma të mëtejshëm do t’i shtohen kësaj Marrëveshjeje; këto do të sigurojnë zhvillimin e mëtejshëm të programit dhe planifikimin e specifikave aktivitetet dhe do të përcaktojnë detyrimet e të dy institucioneve pjesëmarrëse në zhvillime të tilla të mëtejshme.

### Neni 5

#### Vlefshmëria

- a. Marrëveshja do të bëhet aktive në ditën e nënshkrimit dhe do të funksionojë për 2 (dy) vjet nga ajo datë, dhe do të rinovohet automatikisht për periudha të tjera prej 2 (dy) vjetësh nëse nuk anulohet nga asnjëri nga partnerët.



- b. Nëse secili nga partnerët dëshiron të anulojë Marrëveshjen, ata duhet të njoftojnë 6 (gjashtë) muaj përpara afatit dhe akti i anulimit do të jetë pa paragjykim ndaj veprimeve dhe aktiviteteve ekzistuese dhe në vazhdim.
- c. Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje mund të ndryshohet në çdo kohë me pëlqimin e ndërsjellë me shkrim të të dy institucioneve.
- d. Kjo Marrëveshje është përgatitur në gjuhën shqipe në 2 (dy) kopje origjinale dhe secila palë do të mbajë 1 (një) kopje origjinale.

#### Neni 6

#### Kohëzgjatja e marrëveshjes

1. Kjo marrëveshje zbatohet për periudhën 05/06/ 2023 me afat kohor për 2 (dy) vjet nga data e firmosjes.

#### Neni 7

#### Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje lidhur me interpretimin ose zbatimin e kësaj Marrëveshjeje zgjidhet me mirëkuptim mes palëve.

#### Neni 8

#### Hyrja në Fuqi

Marrëveshja hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij dhe publikohet në faqet zyrtare të Palëve. Marrëveshja përgatitet dhe nënshkruhet në 2 (dy) kopje origjinale, një prej te cilave depozitohet në Universitetin "Barleti" (UniBa) dhe një në Dhomën e Tregtisë dhe Industrisë, Tiranë.

Nënshkruar në Tiranë, në \_\_. \_\_. 2023.

**Universiteti "Barleti"**

**Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë, Tiranë**

**Rektor**

**Prof. Dr. Suzana GUXHOLLI**

**Kryetari**

**Z. Nikolin JAKA**